

## KËRKESË PËR INFORMIM

**PER:** LSI, LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM  
**NGA:** INSTITUTI SHQIPTAR I SHKENCAVE / OPEN DATA ALBANIA  
**LËNDA:** KËRKESË PËR INFORMIM PËR FINACIME TË PËRFITUARA ZGJEDHJET VENDORE  
2015  
**DATE:** 2015-06-09  
**CC:** Z. LUAN RAMA – SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

I nderuar zoti Rama,

Me anë të kësaj shkrese, në emër të Institutit Shqiptar të Shkencave dhe në kuadër të programeve tona për transparencë dhe të dhëna të hapura (open data), paraqesim kërkesën për të na mundësuar me shkrim informacion në lidhje me financimin e fushatës për zgjedhjet vendore, prej datës 22 maj 2015 për subjektin tuaj zgjedhor.

Më konkretisht lutemi të na informoni në lidhje me:

- listën e dhuruesve të fondeve jopublike që keni përfituar prej datës 21 maj 2015 dhe që janë mbi shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë ose shërbime apo sende të barasvlershme me të;
- listën e çdo shpenzimi që keni kryer eventualisht prej datës 21 maj 2015 me fondet vjetore të përfituara nga buxhetit i shtetit 2015.

Kërkesa jonë bazohet në nenin 9, paragrafi i tretë i Kushtetutës, neni 87/1, neni 89 dhe neni 90 të Kodit Zgjedhor, si dhe të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 2 shkronja “c”, neni 3 dhe neni 11.

Partitë politike kanë një rol të veçantë në shoqërinë demokratike dhe transparencën në kohë e financimeve të tyre, veçanërisht në fushata zgjedhore, është element me rëndësi themelore. Partitë politike kryejnë detyra publike, kanë një rol unik në një shoqëri demokratike dhe mbartin të drejta dhe detyrime si subjekte të së drejtës publike.

Nga ana tjetër kjo krijon njëherësh mundësinë që të zbatohen në praktikë ato që përbëjnë sjellje transparente dhe demokratike në shoqëri dhe do të sjellin një vlerë të shtuar të këtij procesi zgjedhor.

Më lejoni të kujtoj gjithashtu se në mbështetje të nenit 15, paragrafi i parë i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” lutem na përcillini përgjigjen tuaj brenda 10 ditësh pune nga data e marrjes së kësaj kërkesë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Me respekt

Aranita BRAHAJ

Drejtoreshë Ekzekutive



Instituti Shqiptar i Shkencave

Rruga Asim Vokshi,

Pallati 13/25 kat 3

TIRANË

Email: [aranita.brahaj@ais.al](mailto:aranita.brahaj@ais.al)

Tel: 0682001718




POSTA  
Zyra Postare



RR 183 022 110 AA

Vula:

LAJMËRIM MARRJE N 40  
Lekë



Ky lajmerim - marrje do te kthehet  
ne adresen time si me poshte:

Plotësohet nga dërguesi  
i cili duhet të tregojë drejtimin  
e tij të plotë për kthimin  
e këtij lajmërimi

Mod P6

Z. Aramita, Pralaj  
Instituti Shqiptar i  
Shkencave, Rr "Asim  
Vohshi" Pallat 13/25  
Kati 3 TIRANE

### 1. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA PRANUESE E LAJMERIMIT

Objekti.....Nr.....datë.....Lek.....  
 Është pranuar në zyrën.....ne drejtim të zotit  
 LUAN RAMA - Sekretar, Buge Rishem  
 Rr Sami Frashëri, Godina 20/10  
 TIRANE

### 2. PËR TË PLOTËSUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT

Objekti i sipërtreguar është.....Dorëzuar me datë.....  
 Esmëmbledë  
 Pagar  
 Emri mbiemri  
 I shpërndarësit  
 SHËNIME TË VECANTA  
 Vija datuar e Zyrës  
 Dorëzuese të objektit

*Stamp: SHQIPËRIJA, TIRANE, 10/06/2015*